



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.3/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B. A., duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga A.J, nga J., me banim në lagjen “A. R.” pn, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga A.J, nga J., ndaj gjyqtarit B. A., **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 19.04.2024, A.J, nga J., me banim në lagjen “A. R.” pn, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit B. A. me arsyetimin se gjyqtari ka keqpërdorë detyrën zyrtare me nxjerrjen e Aktgjykimit C.nr.614/22, pa asnjë provë dhe në shpërputhje me çdo normë ligjore pasi në dokumentet kadastrale nuk ekziston rruga publike në pronën e tij, ndërsa gjyqtari vendos për pronën e tij tipik si uzurpator, pasi dihet publikisht se daja i bashkëshortes së gjyqtarit ka interes të kaloj në pronën e tij dhe sigurisht interesi familjar e ka detyruar të abuzoj me ligjin. I njëjti ka shtuar se gjyqtari A., ka mund që menjëherë ta hudh poshtë padinë parashtruar ndaj këtu ankuesit pasi nuk kishte prova, mirëpo me qëllim që të shkaktoj skandale ka mbajtur seanca maratonike, në të cilat seanca janë dëgjuar edhe ekspertët dhe është rast i paprecedent, ku gjyqtari e anashkalon ekspertizën, nuk shikon shënimet zyrtare, e anashkalon gjendjen reale dhe në aktgjykim gënjen hapur, manipulon dhe nuk e cek të vërtetën, duke rënë pre e punëtorit të Komunës së D. – paditësit. Për të lëshuar një aktgjykim të tillë, sipas mendimit të tij, gjyqtari duhet të jetë i shantazhuar apo i kërcënuar, i korruptuar apo të ketë probleme të mëdha mendore dhe sipas informatave që i posedon, ky gjyqtar ka pas ankesa disa herë, mirëpo ndërhyrjet nga politika apo direkt nga Serbia kanë ndikuar që të merr vetëm disa vërejtje të vogla, andaj ka propozuar që të merren hapa konkret sipas ligjit dhe aktgjykimi të kthehet në pikën zero.

Me datë 22.04.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga A.J, ndaj gjyqtarit B. A..

Gjyqtari B. A., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka theksuar se aktgjykimin në fjalë e ka nxjerrë duke u bazuar në prova dhe fakte të bazuara në ligj, të gjitha pretendimet e ankuesit se kinse ka nxjerrë aktgjykim joligjor janë të pabazuara dhe të vetmin qëllim e kanë degradimin e tij personal dhe profesional, pasi një qytetar laik nuk mund të bëjë interpretim ligjor, por i njëjti në mënyrë paushalle jep hipoteza duke shkuar deri në atë masë sa të deklaroj se pas gjyqtarit qëndron shteti i Serbisë, prandaj vlerëson se nuk është në nivelin e tij profesional dhe personal të bie në nivelin e njerëzve të cilët sa herë gjykata bie vendim në disfavorin e tyre, janë të prirur t’a etiketojnë gjyqtarin e çështjes me epitete të

ndryshme. I njëjti ka shtuar se aktgjykimin në fjalë e ka marrë pasi ka shtjerë të gjitha provat dhe faktet në procedurë ligjore, e pas dëgjimit të ekspertëve, dëshmitarëve, daljes në vendin e ngjarjes dhe se të gjitha pretendimet e parashtruara në ankesë disiplinore, pala duhet t'i adresojë në ankesë ndaj aktgjykimit drejtuar gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa ankesën e tillë me epitete të ndryshme, vlerëson se pala e ka bërë nga mos njohja e të drejtës e me qëllim të degradimit të tij personal, e jo duke u bazuar në fakte e prova. Andaj, konsideron se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe si të tilla janë bërë nga personi që ka të vetmin qëllim pengimin e një të drejte subjektive të një personi tjetër, duke shtuar se kontesti mes palëve duhet të zhvillohet me paraqitjen e provave dhe fakteve në gjykatë, e jo duke sharë gjyqtarë e sistemin e drejtësisë pa asnjë provë të vetme, duke e ftuar ankuesin se nëse ka fakte se gjyqtari është i korruptuar duhet t'i ofrojë në adresën e duhur, e jo në mënyrë pushalle të etiketojë gjyqtarin dhe sistemin.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B. A., së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Autoriteti kompetent në vlerësim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës se gjyqtari ka nxjerrë aktgjykim duke keqpërdor detyrën zyrtare dhe se i njëjti ka pas interes familjar në nxjerrjen e një vendimi të tillë, ka gjetur se pretendimet e tilla ankuesi nuk i ka mbështetë në asnjë provë, andaj deklaratimet e tilla si të vetme dhe të pa argumentuara me prova nga ana e parashtruesit të ankesës, nuk mund të merren për bazë për iniciimin eventual të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore se gjyqtari B. A., ka nxjerrë aktgjykim të pabazuar në ligj dhe në prova, e ka anashkaluar mendimin e ekspertëve dhe gjendjen reale, autoriteti kompetent gjen se të njëjtat janë pretendime ankimore për të cilat vendos Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë në rast të parashtrimin eventual të ankesës ndaj aktgjykimit dhe të njëjtat nuk mund të konsiderohen shkelje të natyrës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.3/24, me datë 02.05.2024.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B. A.*
- 3. Parashtruesit të ankesës – A.J, nga J.*

